



PARAJMËRIM NGA BIDATI

nga shejh Salih el-Feuzan

PARALAJMËRIM NGA BIDATI

SALIH IBËN FEUZAN

EL FEUZAN



Hytbja e parë:

Lavdia i qoftë Allahut, Zotit të krijesave. Ai na e ka plotësuar për ne fenë, e ka përmbushur mbi ne mirësinë e Tij, dhe është kënaqur me Islamin si fe për ne. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të vetëm e të pashok, dhe kush i bën shirk Allahut vetëm se ka devijuar qartazi. Dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut, salavatet e Tija të shumta qofshin mbi të dhe mbi shokët e tij.

Më pas...

O njerëz! E lëvdojmë Allahun dhe e falenderojmë për këtë Fe, me të cilën Allahu ka dërguar peygamberin e Tij Muhamed sal- lAllahu alejhi ue sel-

lem, dhe ka dëshmuar për përkryeshmërinë e kësaj Feje duke thënë:

“Sot kam përsosur për ju fenë tuaj”. [el Maideh: 3].

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk ka ndërruar jetë, vetëm pasi Allahu e ka përkryer fenë përmes tij, duke mos i lënë askujt mundësi të sjellë diçka që të afron tek Allahu, që mos ta ketë sjellë ai. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë:

“Ju kam lënë në të qartë, ku nuk humb prej saj vetëm se një i shkatërruar”.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë:

“Vërtet unë po lë mes jush, atë, që po t’i përmbaheni pas meje, nuk do të humbisni; Librin e Allahut dhe Sunetin tim”.

Allahu xhel-le ue ala“ na ka thënë neve:

“Kjo është rruga Ime e drejtë, andaj ndiqeni, dhe mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’u ruajtur nga të këqijat”. [el En“am: 153].

Kjo është rruga e Allahut me të cilën ka ardhur Pejgamberi sal- lAllahu alejhi ue sel-lem; nuk ka lënë gjë të cilën e afron muslimanin tek Allahu, vetëm se e ka sqaruar, dhe nuk ka gjë të dëmshme për fenë dhe dynjanë e muslimanit, vetëm se ka

paralajmëruar prej saj. Neve nuk na ka mbetur tjetër veç pasimit (ndjekjes) dhe braktisjes së shpikjes (së bidateve), sepse gjithë e mira është tek pasimi, ndërsa gjithë e keqja është tek shpikja. Allahu xhel-le ue ala“ nuk kënaqet vetëm se me fenë që Ai e ka ligjëruar për njerëzit, andaj nuk i lejohet askujt të ligjërojë bashkë me Allahun adhurime, e pastaj të thotë „kjo është prej fesë“, **“A kanë ata idhuj, të cilët u kanë ligjëruar një fe që nuk e ka lejuar Allahu?!”. [esh-Shura: 21].**

Detyra ynë është të pasojmë dhe të braktisim shpikjen (e bidateve). Abdullah ibën Mes“udi radijAllahu anhu ka thënë: **“Pasoni dhe mos shpikni bidate, e kjo ju mjafton!”.**

Ai i cili kërkon kënaqësinë e Allahut, dhe kërkon Xhenetin, ai duhet të pasojë dhe të kapet për këtë fe; në të është mirësia dhe e plotë për atë që Allahu subhanehu ue teala i jep sukses. Mirëpo, shejtanët nga mesi i njerëzve dhe xhinëve, nuk duan vetëm se të shpikin në këtë fe bidate që i mendojnë se afrojnë tek Allahu. Ata janë kapur pas tyre me zell dhe kanë bërë thirrje drejt tyre, e kjo në mënyrë të vazhdueshme. Kjo bën pjesë tek belatë dhe sprovat:

“Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënëin kështu, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre”. [el En‘am: 112].

Vërtet bidati të largon nga Allahu,

ndërsa Suneti të afron tek Ai. Vërtet bidati e hidhëron Allahun, ndërsa Suneti e kënaq Atë subhanehu ue tealë, sepse Allahu ka thënë:

“Jam kënaqur për ju me Islamin për fe”. [el Maideh: 3].

Bidatçiu e mendon veten në të vërtetë, dhe rrallë herë bidatçiu pendohet; sepse ai e mendon veten në të vërtetë, kurse ai është më keq se gjynahqari. Gjynahqari e din se është kundravajtës, dhe turpërohet prej Allahut, turpërohet prej njerëzve dhe është afër pendimit tek Allahu azze ue xhel-le, ndërsa bidatçiu e mendon veten në të vërtetë, se është udhëzim, dhe nuk pendohet.

Prej dëmeve të bidatit, është ajo që ka

ardhur në hadith:

“Një popull nuk shpikën një bidat, vetëm se Allahu ngre një Sunet”.¹

Nuk bashkohet një Sunet me një bidat, vetëm se njëri dëbon tjetrin. Suneti dëbon bidatin, dhe bidati dëbon Sunetin. Ai që kërkon shpëtimin dhe shpërblimin, le të mjaftohet me atë që Allahu subhanehu ue teala ka ligjëruar, dhe mos të kthehet nga ajo çfarë njerëzit thonë pa argument. Kush të vjen dhe të thotë “bëj kështu sepse ka shpërblim”, thuaji “me jep argument për këtë”. Nëse të sjell argument, po, e nëse nuk të sjell argument, atëherë

¹ Vlersuar si hadith i dobët nga shejh Albani në “ed-Daifeh” nr. 6707.

ai është i humbur dhe humbës.

Ne duhet të tregohemi të vëmendshëm ndaj kësaj, sidomos kur ne jemi në një kohë kur reklamohen bidatet me shumicë, kur tek njerëzit dominon injoranca dhe shumë prej njerëzve kanë dëshirë për të bërë hajër, dhe e duan shpërblimin, mirëpo kjo shfrytëzohet, me hutimin e shumë prej dijetarëve, dhe ata i përhapin mes njerëzve këto helme, sidomos nëpërmjet këtyre mjeteve bashkohore; interneti, celulari, webfaqet.

Ata i përhapin këto helme mes njerëzve, duke i dërguar mesazhe nëpër celularë: “bëni kështu, agjëroni kështu, faluni kështu”. Ata i

nxisin në këto gjëra, dhe thonë:
“kush e bën këtë, ai ka shpërblim,
ndërsa kush e braktisën, do të ketë
ndëshkim”.

Kështu i mveshin disa lloje
ndëshkimesh dhe frikësimesh atyre
të cilëve nuk veprojnë çfarë
përhapin, bile ata urdhërojnë
personat që u kanë mbërritur këto
“fantazira”, që t’i shpërndajnë mes
njerëzve dhe t’ua përcjellin atyre,
dhe se kjo gjë ka shpërblim kaq dhe
aq nëse shpërndahet, e nëse e
mbajnë të fshehur, atëherë do të
kenë kaq dhe aq gjynah, dhe le të
presë ndëshkim të afërt.. kërcënine
të ngjashme dhe premtime për
shpërblim për ata që i pranojnë dhe i
reklamojnë. Kështu pra veprojnë,

andaj ruhu prej tyre, dhe mos prano prej njeriu ndonjë adhurim, apo ndonjë vepër që shpresohet prej saj shpërblim vetëm se me argument nga Kurani dhe Suneti. Ata përmendin hadithe të trilluara me të cilat i nxisin njerëzit përmes tyre, apo shpikin hadithe me të cilat i nxisin njerëzit.

Ruhuni o robër të Allahut! Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

“Kush gënjen mbi mua me qëllim, atëherë le të përgatisë vendin e tij në Zjarr”.

Mirëpo, shejtani i ka bërë të rrëshqasin, i ka humbur dhe mashtruar, dhe ata tani duan që

njerëzit t'i pasojnë dhe t'i ndryshojnë njerëzve fenë.

Ruhuni prej tyre, ruhuni prej këtyre mjeteve dhe prej asaj që përhapet në to, mos pranoni prej tyre diçka, vetëm pasi të keni pyetur dijetarët nëse ju nuk dini. E nëse dini, atëherë shfaqini ato [që ju dërgohen përmes këtyre mjeteve] Kuranit dhe Sunetit, ngushtojani atyre rrugët lidhur me këtë gjë.

“Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërroi atë dhe ajo zhduket. Dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni (Allahut!)”. [el Enbija“: 18].

“Thuaj: e vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht,

e pavërteta është e paracaktuar të zhduket”. [el Isra“: 81].

E vërteta është përpara jush – lavdi Allahut -; Libri i Allahut, Suneti i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, keni dijetarët, andaj pyetini rreth asaj që shpërndahet dhe çfarë thuhet. Mbylljani rrugët dhe ngushtojini, derisa ata të largohen prej jush dhe prej veprave të tyre të shëmtuara, kur ata mos të kenë mundësi reklamimi, dhe kur të kuptojnë se rrugës së tyre kanë njerëz që i refuzojnë dhe i kundërpërgjigjen.

Ruhuni nga këto gjëra, Allahu ju dhëntë sukses! Prej këtyre bën pjesë fakti se ata çdo fund vit, në fund të

vitit hixhri, në fund të muajit Dhul Hixheh urdhërojnë për disa dhikre, për adhurime, për të agjëruar ditën e fundit të muajit Dhul Hixheh, i urojnë njerëzve vitin e kaluar, dhe i urojnë sikur i urojnë për Fitër Bajram apo Kurban Bajram. Të gjitha këto janë përralla dhe kotësira për të cilat Allahu nuk ka zbritur argument. Ata nxisin për gjëra gjatë sezoneve të hajrit duke i futur mes njerëzve, duke shfrytëzuar zellin dhe dëshirën e muslimanit që ka për të bërë hajër, kurse ata fusin të tilla gjëra.

Ruhuni dhe paralajmëroni të tjerët prej tyre. Vërtet viti hixhri nuk ka ndonjë veçori dhe nuk është prej gjërave që ka ardhë Sheriati me të,

mirëpo është rënë në pajtim për të.

Sahabët kanë rënë dakort për të, pasi Omeri radijAllahu anhu i mblodhi sahabët, sepse atij i vinin shkresat prej përgjegjësve të tij, dhe ai nuk e dinte se kur ishin shkruar. Për këtë, ai u konsultua rreth vendosjes së kalendarit për muslimanët. Ata nuk i kushtuan rëndësi kalendarit gregorian, edhe pse ai ishte prezent, sepse ne jemi ndaluar nga përngjasimi me çifutët dhe të krishterët. Ata nuk i kanë kushtuar rëndësi kalendarit gregorian, as atij pers dhe asnjë kalendari tjetër, sepse ne jemi ndaluar nga përngjasimi me të tjerët. Kështu që, ata u pajtuan që fillimi i muajit el Muharrem të jetë fillimi i vitit hixhri, ndërsa muaji

Dhul Hixheh të jetë fundi i vitit. Ky është pajtim i tyre, nuk kanë patur për qëllim që të caktojnë adhurime, vlera apo diçka tjetër bazuar në këtë gjë. Mirëpo, njerëzit e këqinj mbi këto shkaqe

ndërtojnë dhe flasin rreth tyre gjëra që Allahu nuk ka zbritur argument.

Paralajmëroni prej tyre dhe ruhuni! Mos i reklamoni këto gjëra, sepse ka prej atyre që i marrin këto fletë të shkruara dhe i shpërndajnë, i fotokopjojnë dhe i shpërndajnë, e mbase i ngjesin tek dyert e xhamiave apo brënda tyre. Kjo, sepse ata thonë se kush i reklamon dhe qarkullon, ka kaq dhe aq shpërblim, do të marrë, do të ngrihet... dhe njerëzit kërkojnë hajrin e tanishëm dhe atë të

mëvonshëm. Me këto gjëra ata i mashtrojnë njerëzit.

Ruhuni dhe paralajmëroni të tjerët prej tyre. Allahu i dhëntë sukses të gjithëve drejt asaj që e don dhe e kënaq. O Zot, na e shfaq të vërtetën të vërtetë dhe na mundëso pasimin e tij, dhe na e shfaq të kotën të kotë dhe na mundëso distancimin prej tij, dhe mos e bëj atë të paqartë për ne, e pastaj të humbasim. Them këto fjalë, i kërkoj falje Allahut për vete, për ju dhe për të gjithë muslimanët nga çdo gjynah, andaj edhe ju kërkoji Atij falje, vërtet Ai është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.

Hytbja e dytë:

Lavdia i takon Allahut për mirësitë e

Tija, Atë e falenderoj për suksesin dhe mirësitë e Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të vetëm e të pashok, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguri i Tij. Salavatet dhe selamet qofshin për të, familjen dhe shokët e tij.

El Irbad ibën Sarijeh radijAllahu anhu transmetohet se ka thënë: na ka këshilluar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me një këshillë prekëse, prej të cilës zemra u rrënoqeth dhe sytë lotuan, andaj thamë: o i Dërguari i Allahut! Kjo sikur të ishte këshillë lamtumire, andaj na porosit! Dhe tha:

“Ju porosis për devotshmëri, të dëgjoni dhe bindeni, edhe sikur

t'ju prijë një rob, sepse kush do të jetojë prej jush, do të shohë mospajtim të shumtë, kështu që përmbahuni Sunetit tim dhe Sunetit të halifëve në rrugë të drejtë dhe të udhëzuar pas meje, kapuni për to me dhëmballë. Ruhuni nga gjërat e shpikura, sepse çdo shpikje është bidat, dhe çdo bidat është humbje". Ndërsa në një transmetim:

“dhe çdo humbje është në Zjarr”.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nëse mbante hytbe, thoshte:

“Vërtet fjala më e mirë është Libri i Allahut, dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Gjërat më të këqija janë ato të shpikura, çdo bidat është humbje, dhe çdo humbje është në Zjarr”.

Vini re thënien e tij: **“çdo bidat është humbje”**. Në bidat nuk ka gjë të mirë, nuk ka bidat të mirë, përkundrazi, të gjitha janë humbje andaj largohu prej tyre. Ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij na kanë ligjëruar, është më e mirë për ne, është komplet e mirë. Kush synon të mirën, atëherë ja tek janë Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit sal-

lAllahu alejhi ue sel-lem, dhe le të përpiqet në kërkimin e shpërblimit tek ajo që ka ligjëruar Allahu subhanehu ue teala. Largohu nga bidati, sepse bidatçiu sado të veprojë, sikur jetën e tij ta shuajë në bidat, ai është prej banorëve të Zjarrit ndërsa vepra e tij është humbje, Allahu na mbroftë! Kjo sepse ai ecën në rrugë të gabuar, në rrugë që nuk e ka ligjëruar Allahu. Nëse ai mjaftohet me disa bidate, atëherë ka gjynah në masë të tyre, mirëpo, egziston frika se mos këto bidate të progresojnë, dhe t'i japin fund suneteve përreth, e më pas ai të bëhet një bidatçi i kulluar.

Frikësohuni Allahut o robër të Tij!
Paralajmëroni prej bidatit dhe mos

toleroni në të, apo të thoni “kjo është e mirë”, “kjo

është vepër e devotshme” duke toleruar në këtë çështje. Jo pasha Allahun! Sepse bidati është i keq dhe nuk është i mirë, ai është humbje dhe jo vepër e devotshme.

Frikësohuni Allahut o robër të Tij! Kapuni për fenë tuaj sepse rreziku është i madh. Vërtet thirrësit e devijimit janë aktivë dhe aktivizohen nga ana e shteteve mosbesimtare; i ndihmojnë dhe inkurajojnë në këtë gjë, në mënyrë që ta prishin këtë fe, mirëpo:

“Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mosbesimtarët ta urrejnë këtë gjë”.
[et-Teube: 32].

Pastaj dijeni Allahu ju mëshiroftë, se Allahu ju ka urdhëruar me një urdhër që ia ka nisur nga Vetja e Tij, dhe ka thënë:

“Vërtet Allahu dhe melaiket dërgojnë salavate për të Dërguarin. O besimtarë, dërgoni salavate dhe përshëndeteni atë me selam!”. [el Ahzab: 56].

O Zot dërgo salavate dhe selame për robin dhe të Dërguarin tënd Muhamed! O Zot kënaqu me halifët në rrugë të drejtë, me imamët e udhëzuar; Ebu Bekrin, Omeri, Othmanin, Aliun, sahabët në përgjithësi dhe ata që i pasojnë deri në Ditën e Gjykimit!

O Zot krenojë Islamin dhe

muslimanët, nënçmoje shirkun dhe
idhujtarët, shkatërroji armiqtë e fesë,
bëje këtë vend dhe vendet

e tjera muslimane të sigurta dhe të
qeta! O Zot ruaji këto vende dhe bëji
të sigurta dhe të qeta! O Zot ruaji
nga trazirat! O Zot ruaji nga kurthet
e kurthëngritësve, dhe nga e keqja e
armiqve dhe ziliqarëve! O Zot ruaji
këto vende dhe vendet e tjera
muslimane dhe bëji të sigurta dhe të
qeta!

O Zot ndreqi prijësit tanë, dhe bëji
ata të udhëzuar që udhëzohen! O Zot
ndihmoji ata me ndihmë dhe sukses!
O Zot bëji ata ndihmë për fenë
Tënde, luftë për armiqtë Tuaj, dhe
paqë për evlijaët Tuaj o Zoti i
krijesave! Na mbro nga e keqja e

trazirave, të qarta dhe të paqarta! O Zot na forco në të vërtetë, na udhëzo në rrugën e drejtë dhe na bëj të vdesim si muslimanë!

“O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Vërtetë Ti je Dëgjuesi dhe i Gjithëdituri”. [el Bekare: 127].

Robër të Allahut!

“Vërtetë Allahu urdhëron për drejtësi, mirësi dhe ndihmë për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju përkujtoni. Zbatoni besën e Allahut kur ta merrni mbi vete, dhe mos e thyeni betimin pasi ta keni bërë atë, sepse Allahun e keni bërë garantin tuaj; vërtet

Allahu e di se çfarë bëni ju". [en-Nahl: 90-91].

Kujtoni Allahun t'ju kujtojë ju, falenderojeni Atë për mirësitë e Tij dhe do t'ju shtojë, përkujtimi i Allahut është më i madh, dhe Allahu e din se çfarë veproni.

Mbajtur më 12 el Muharrem 1435 h

Burimi i origjinalit (arabisht):

<http://www.alfawzan.af.org.sa>

[/node/15038](#)

Përktheu: Besmir Cacani



www.indeksiislam.com